



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBËR  
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE**

**Data: 16.04.2026**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS Blerje materiale per lyrjen e objekteve**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV) ): Bojra  
(44810000-1)**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 1.249.883** (Nje milion e dyqind e dyzet e nentemije e teteqind e tetedhjete e tre ) **leke pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor BASHKIA DIBER ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin e ofertes sipas shtojces 1:*

*b. Lista e cmimeve te artikujve sipas shtojces 2;*

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8:

c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, pika 1, 82 pika 1 dhe 83 pika 1 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:**

**2.1.1** Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 7 të DST-ve (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, të LPP, *ky kriter kerkohet sepse verteton se opertoret ekonomik kane kapacitetet e duhura ligjore per kryerjen e furnizimeve te mallrave*

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar gjatë viteve 2023,2024 dhe 2025 ku vlera mesatare e të tre viteve të jete jo me e vogel se 40 % e fondit limit, të vërtetuar me një dokument të lëshuar nga administrata tatimore.

*Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:Ky kriter vendoset per te siguruar opertoret ekonomik kapacitetet financiare te duhura per permbushjen e kushteve te kontrates.**

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në neni nenin 43 pika 2 germa c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku citohet:

***c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.***

**2.2.3.** Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2025**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e

bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

*Shenim: Per kete pike 2.2.3 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.*

*Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 "Per QKB" i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "Per QKR" i ndryshuar.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme te ngjashme,te kryera gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates,ne vlere jo me te vogel se 20 % te vleres se fondit limit te kesaj kontrate.

**Per te vertetuar pervojen e meparshme te ngjashme, operatoret ekonomik duhet te paraqesin deshmitte si meposhte:**

**2.3.1.a** *Per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin publik,operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohet vlere, afati I perfundimit te kontrates ose/dhe fatura tatimore e shitjes te plotesuara sipas legjislacionit ne fuqi, ku shenohet data,shuma,dhe sasite e mallrat e furnizuara.*

**Ose**

**2.3.1.b** *Per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin privat ,operatori ekonomik duhet te paraqese fatura tatimore te shitjes,te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe te deklaruar ne organet tatimore,ku shenohet data dhe sasite e mallarve te furnizuara.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 4, nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Ky kriter është përcaktuar dhe është vertetuar eksperiencën e mëparshme të operatorëve ekonomikë.

---

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 9001 2015** (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) (e vlefshme) **ose ekuivalente e saj**.

Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nënnt 79 , pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku citohet:

*1) Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt i prokurimit, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

---

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi ose me qera, 1 (një) automjet deri në 3.5 ton për transportin e mallrave, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtme: *Per mjetet në pronësi: Certificate pronësie, leje qarkullimi, taksat vjetore, kolaudim (kontrollin teknik) (te vlefshme), sigurim (police sigurimi) (te vlefshme) dhe licence për transportin të mallrave.*

- *Per mjetet e marra me qera: Kontrata qeraje (te vlefshme) Certificate pronësie, leje qarkullimi, taksat vjetore, kolaudim (kontrollin teknik) (te vlefshme), sigurim (police sigurimi) (te vlefshme) dhe licence transportit të mallrave (te vlefshme).*
- Për makineri teknologjike dhe mjete që nuk shënohen në regjistra publikë (makineritë teknologjike), kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse.
- Ndërsa për makineri teknologjike dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur faturë zhdoganimit ose faturë tatimore blerje) dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;

- Për paisjet kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontratë blerje/faturë zhdoganimi/faturë tatimore blerje.

*Kriteri per piken 2.3.3 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.*

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

*Ky kriter kerkohet ne baze te afatit per zbatimin e kontrates dhe zerave te preventivit qe operatoret ekonomik te disponojne ne pronesi ose me qera I mjete, per transportimin e mallrave objekt kontrate, dhe te beje te mundur permbushjen e kontrates ne menyre sa me te rregullt dhe me sukses sipas kerkesave te AK Bashkia Diber.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

## **NJESIA E PROKURIMIT**